



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Numri i lëndës: 2023:276828  
Datë: 24.05.2024  
Numri i dokumentit: 05731861

**K.Dh.Sh II.nr.182/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit KOSTT-Operator, Sistemi, Transmisioni dhe Tregu sh.a, me NUI 8112854512, me seli në rr. “Isa Boletini” nr.39, Prishtinë, kundër debitorit KESco – Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike sh.a, me NUI 811288887, me seli në rr. “Bulevardi Bill Klinton”, Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2138/22 të datës 29.11.2023, me datë 21.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e debitorit KESco – Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike sh.a, ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2138/22 të datës 29.11.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2138/22 të datës 29.11.2023, ka vendos si në vijim; në pikën I të dispozitivit ka përfunduar procedurën përmbartimore sipas urdhrit përmbartimor P.nr.139/2022 të datës 18.08.2022, i caktuar nga Përmbartuesi Privat Myjesere Mujku lidhur me

kërkesën për kryegjënë në shumë prej 1,889,605.55 € (Një milion e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e pesë euro e pesëdhjetë e pesë cent), për shkak tërheqjes së pjesërishme të propozimit për përmbarrim të kreditorit “KOSTT – Operator, Sistemi, Transmisioni dhe Tregu” Sh.a me NUI 811284512 kundër debitorit “KESCO – Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike” Sh.a me NUI 811288887 me seli në Prishtinë. Ndërsa në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit të përmbarrimit KESCO – Kompania Kosovare për Furnizimi me Energji Elektrike sh.a, me NUI 811288887, duke lënë në fuqi pjesërisht urdhrin përmbarrimor P.nr.139/2022 të datës 18.08.2022 i caktuar nga Përmbarruesi Privat Myjesere Mujku me të cilin është caktuar përmbarrimi për kamatë vjetore prej 4,5 % dhe shpenzimet procedurale.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të gjendjes faktike si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2138/22 të datës 29.11.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori KOSST – Operatori, Sistemi, Transmisioni dhe Tregu Sh.a, ka paraqitur propozim për përmbarrim në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturë nr. 065 e datës 10.03.2022 me nr. të protokollit 424 të datës 10.03.2022, fatura nr.068 e datës 10.03.2022 me nr. të protokollit 426 e datës 10.03.2022 dhe kërkesa për pagesën e detyrimeve për llogarinë e balancimit për periudhën janar-mars 2022 (tri sosh), me nr. të protokollit 1085,1086 dhe 1087, që të tria të datës 02.06.2022, me të cilin është urdhëruar debitori që në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij urdhri ti përmbushë të gjitha detyrimet nga paragrafi i mësipërm i këtij urdhri dhe të bëjë bartjen e mjeteve në llogarinë bankare të kreditorit KOSTT. Nëse debitori nuk e kryen

pagesën e pretenduar nga kreditori në shumë prej gjithsej 1,889,605.55 €, me kamatë vjetore 4,5 % - sipas rregullave të tregut, nga data kur kërkesa është bërë e arritshme si dhe pagesën e shpenzimeve procedurale, atëherë përmbartimi do të zbatohet duke i urdhëruar bankat komerciale të Kosovës, që ti bllokojnë dhe debitojnë llogaritë bankare të debitorit deri në shumën e borxhit kryesor, me kamatë vjetore 4.5 % si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, aq sa do të krijohen deri në pagesën definitive të borxhit-konform UA të MD-së nr.01/2022.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, si dhe në seancën dëgjimore ka kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbartimor, me arsyetim se faturat lëndore nuk janë dokumente të besueshëm, me që ato janë pro-fatura, përkatësisht notë debit dhe notë kredit e që nuk mund të konsiderohen fatura. Shton se, nuk vërtetohet se fatura lëndore së bashku me notë debit janë nënshkruar nga Debitori si dhe përshkrimi i faturës nuk i përmban elementet e një fature që të konsiderohet e besueshme sipas ligjit, rrjedhimisht Urdhri ka të meta substanciale pasi bazohet në dokumente që nuk i plotësojnë kushtet ligjore për tu trajtuar si dokumente të besueshme. Gjithashtu ka shtuar se Propozimi nuk është në përputhje me nenin 38 të LPP-së. Përveç kësaj, ai ka argumentuar se kjo çështje do të duhej të trajtohej në procedurën kontestimore, meqë duhet të bëhet ekzaminimi i provave veç e veç. Debitori ka theksuar se borxhi eventual është rezultat i krizës globale energjetike, rrjedhimisht nuk mundet si i vetëm ta bart përgjegjësinë kryesore për përmbushjen e tij. Tutje ka theksuar se me qëllim të parandalimit dhe zvogëlimit të pasojave që do të krijoheshin nga kjo situatë, kishte marrë një sërë veprimesh duke alarmuar të gjitha institucionet kompetente për gjendjen e krijuar duke përfshirë: Zyrën e Rregullatorit për Energji, Ministrinë e Ekonomisë së Kosovës, Qeverinë e Republikës së Kosovës, Korporatën Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbartimor, me arsyetim se faturat lëndore nuk janë dokumente të besueshëm, meqë ato janë pro-fatura, përkatësisht notë debit dhe notë kredit e që nuk mund të konsiderohen fatura. Shton se, nuk vërtetohet se fatura lëndore së bashku me notë debit janë nënshkruar nga Debitori si dhe përshkrimi i faturës nuk i përmban elementet e një fature që të konsiderohet e besueshme sipas ligjit, rrjedhimisht Urdhri ka të meta substanciale pasi bazohet në dokumente që nuk i plotësojnë kushtet ligjore për tu trajtuar si dokumente të besueshme. Gjithashtu ka shtuar se Propozimi nuk është në përputhje me nenin 38 të LPP-së. Përveç kësaj, ai ka argumentuar se kjo çështje do të duhej të trajtohej në procedurën kontestimore, meqë duhet të bëhet ekzaminimi i provave veç e veç. Debitori ka theksuar se borxhi eventual është rezultat i krizës globale energjetike,

rrjedhimisht nuk mundet si i vetëm ta bartë përgjegjësinë kryesore për përmbushjen e tij. Tutje ka theksuar se me qëllim të parandalimit dhe zvogëlimit të pasojave që do të krijoheshin nga kjo situatë, kishte marrë një sërë veprimesh duke alarmuar të gjitha institucionet kompetente për gjendjen e krijuar duke përfshirë: Zyrën e Rregullatorit për Energji, Ministrinë e Ekonomisë së Kosovës, Qeverinë e Republikës së Kosovës, Korporatën Vendimi Nr.077/22 i dt. 08.02.2022, Letër për ZRRE e dt. 1.02.2022, Letër për ZRRE e dt.22.04.2022, Përgjigje e ZRRE-së me dt.29.04.22.

Kreditori në përgjigje në prapësim dhe në seancën dëgjimore ka kundërshtuar në tërësi atë dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj të njëjtin. Ka theksuar se prapësimi nuk është bazuar taksativisht në asnjërin nga shkaqet e nenit 71 të LPP-së. Më tutje ka theksuar se faturat lëndore i përmbajnë të gjitha elementet e dokumentit të besueshëm. Për më tepër, sipas Kreditorit, këto fatura rrjedhin si obligim nga Marrëveshja për Aderim në Rregullat e Tregut të nënshkruar nga palët. Më tutje ka sqaruar se Debitori i ka pranuar dhe paguar në të kaluarën faturat e ngjashme. Kreditori gjithashtu ka deklaruar se faturat janë dorëzuar në origjinal së bashku me Propozimin. Po ashtu ka theksuar se nuk ka pasur asnjë lloj kushti që është dashur të plotësohet para pagesës së faturave. Ai gjithashtu ka sqaruar se objekt i kësaj lënde janë faturat, rrjedhimisht lënda duhet të trajtohet në procedurën përmbartimore e jo në procedurën kontestimore. Përveç kësaj, Kreditori ka pretenduar se Debitori asnjëherë nuk i ka kundërshtuar faturat lëndore, edhe pse neni 18 i marrëveshjes për aderimin në rregullat e tregut i ka mundësuar. Për fund ka shtuar se konstatimi i Debitori se është dëmtuar nga kriza energjetike nuk mjafton për të refuzuar përmbushjen e borxhit, ngase kjo krizë e ka përfshirë edhe vet Kreditorin i cili ka përmbushur obligimet financiare pavarësisht rrethanave të cilave i referohet debitori. Gjykatës i ka kërkuar të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbartimor.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit dhe pas mbajtjes së seancës dëgjimore të datës 20.11.2023, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2138/22 të datës 29.11.2023, ku në pikën I të dispozitivit ka përfunduar procedurën përmbartimore sipas urdhrit përmbartimor P.nr.139/2022 të datës 18.08.2022, i caktuar nga Përmbartuesi Privat Myjesere Mujku lidhur me kërkesën për kryegjënë në shumë prej 1,889,605.55 € (Një milion e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e pesë euro e pesëdhjetë e pesë cent), për shkak

tërheqjes së pjesërishme të propozimit për përbarim të kreditorit “KOSTT – Operator, Sistemi, Transmisioni dhe Tregu” Sh.a me NUI 811284512 kundër debitorit “KESCO – Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike” ShA me NUI 811288887 dhe seli në Prishtinë. Ndërsa në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit të përbarimit KESco – Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike sh.a, me NUI 811288887, duke lënë në fuqi pjesërisht urdhrin përbarimor P.nr.139/2022 të datës 18.08.2022 i caktuar nga Përbaruesi Privat Myjesere Mujku me të cilin është caktuar përbarimi për kamatë vjetore prej 4,5 % dhe shpenzimet procedurale.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe përfundoi procedurën përbarimore, për shkak se ka konstatuar se urdhri i dhënë nga përbaruesi privat është i mbështetur në dokumentin e besueshëm - faturat e lartcekura, të cilat i plotësojnë të gjitha kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29 paragrafi 1.3 të LPP-së, dhe të njëjtat edhe janë përmbushur nga debitori. Ndërsa gjykata e shkallës së parë vendosi si në pikën II të dispozitivit duke refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe ka lënë në fuqi urdhrin përbarimor P.nr.139/2022 të datës 18.08.2022, sa i përket kamatës prej 4.5% dhe shpenzimeve procedurale sepse debitori është vonuar në përmbushjen e detyrimit, andaj kreditori ka të drejtë të kërkoj përmbushjen e plot të kamatëvonesës së përcaktuar në faturat lëndore.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të kujdest dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore kur e ka refuzuar pjesërisht

prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturave të lëshuara nga kreditori, e të cilat fatura përmbajnë elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar pasi që se faturat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbartimi janë bërë pa efekt juridik në shumën prej 1,889,605.55 € (Një milion e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e pesë euro e pesëdhjetë e pesë cent), kjo për shkak të pagesës nga debitori ndërsa sa i përket kamatës për vonesë në lartësi prej 4.5% mbi borxhin kryesor meqë debitori nuk e ka paguar borxhin me kohë vendosi që për këtë pjesë urdhri përmbartimor ta lë në fuqi. Andaj edhe kjo gjykatë e mbështet aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë si dhe arsyet e cekura në aktvendimin e ankimuar, ngase edhe kjo gjykatë vlerëson se urdhëri përmbartimorë të mbetet në fuqi sa i përket kamatës në lartësi prej 4.5% e cila përputhet me lartësin e përcaktuar me nenin 18 (faturim dhe pagesa) para 3 nënparagrafi 4 të “Rregullat e Tregut” versioni 3.0 të nxjerra nga Operatori i Sistemit të Transmentimit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) të tetorit 2018 ku e njehta ishte kërkuar nga kreditori dhe lejuar me urdhër përmbartimor, për shkak se debitori është vonuar në përmbushjen e detyrimit, andaj dhe kreditori ka të drejtën të kërkoj përmbushjen e plotë të kamatëvonesës së përcaktuar në faturat lëndore.

Kështu, Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykate i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata vlerësoj pretendimet ankimore të debitorit por që pretendimin në fjalë nuk patën ndikim në vendosjen ndryshe. Përndryshe në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin

vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-DHOMA E SHKALLËS SË DYTË**

**K.DH.SH.II nr.182/24 me datë 21.05.2024**

Gjyqtarja  
Franciska Zhitija Ymeri

Numri i lëndës: 2023:276828  
Datë: 24.05.2024  
Numri i dokumentit: 05731861